

**Raporti vjetor për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimet e vitit 2021 nga Drejtoria e
Auditimit Brendshëm - Bashkia Korçë**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E AUDITIMIT TE BRENDSHEM**

**RAPORTI VJETOR PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË AUDITIMET E VITIT
2021**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e Bashkisë Korçë, përcjell sipas kërkesave dhe standarteve të auditimit, Raportin vjetor mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të AB, për angazhimet e kryera në vitin 2020, sipas detyrimit ligjor të pikës 3, kapitulli IV i Udhëzimit nr. 42, dt.27.10.2020 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, dalë në zbatim të nenit 14 të Ligjit nr. Nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Ky raport pasqyron në mënyrë të detajuar nivelin e pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga AB në auditimet e realizuara në vitin 2021.

Raporti gjithashtu siguron të dhëna statistikore të paraqitura në pasqyrat nr.1 dhe nr.2 bashkëlidhur, të cilat janë hartuar sipas formateve të unifikuara nga Drejtoria e Harmonizimit për AB, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimin nr.42, dt,27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”.

Përveçse qëllimit raportues këta tregues të cilët pasqyrojnë performancën e punës së drejtorisë, do të jenë objekt i analizës së performancës, vlerësimit të cilësisë së shërbimit, etj për të siguruar një tendencë pozitive në rritje të treguesve në terma afatshkurtër e afatgjatë.

Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin 2021, drejtoria e auditimit e bashkisë Korçë realizoi në muajin mars 2022, angazhimin për verifikimin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve në subjektet e audituara gjatë vitit 2021.

Të gjitha subjektet e audituara, i janë përgjigjur rekomandimeve të auditimit për korigjimin e parregullsive, duke dëshmuar se ato kanë qënë të duhurat dhe se kanë ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit dhe shtimin e vlerës së subjekteve publike.

Për vitin 2021 janë propozuar gjithësej 36 rekomandime, nga të cilat rezultojnë 25 të zbatuara dhe 11 janë në proces zbatimi por të papërfunduara plotësisht.

Sipas kategorive realizimi i rekomandimeve është :

- ✓ Për përmirësimin e sistemeve janë propozuar 29 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht nga menaxhimi. 22 rekomandime janë realizuar dhe 7 janë në proces zbatimi por të papërfunduara plotësisht, kjo për arsye kryesisht, të njohjes së strukturave me bazën ligjore, të zbatimit të tyre në punën dhe dokumentacionin e vitit 2022, të plotësimit të strukturave me punonjësit e miratuar dhe të bashkërendimit të punës midis strukturave.
- ✓ Me karakter organizativ është propozuar 7 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht nga menaxhimi. 3 rekomandime janë realizuar dhe 4 janë në proces për arsye se janë lënë afatet për tu zbatuar në vitin 2022.

**Raporti vjetor për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimet e vitit 2021 nga Drejtoria e
Auditimit Brendshëm - Bashkia Korçë**

Rekomandimet janë dhënë kryesisht në përmirësimin e punës për :

Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në bashki, që përfshin detyrat e përgjegjësitë për menaxhimin e burimeve njerëzore, funksionimin e strukturës së IT, logjistikës, protokoll arkivën dhe emergjencat civile, ka rezultuar me mangësi në:

Plotësimin e vendeve vakante në personelin e drejtorisë sipas strukturës së miratuar;

Zbatimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm si rregullorja e funksionimit, kodi i etikës, identifikimi i riskut dhe strategjia për menaxhimin e tij, aktivitetet e kontrollit, funksionimi i sistemit të informacionit e komunikimit dhe monitorimi i aktiviteteve;

Caktimin e kriterëve dhe zbutjen e diferencave në nivelet e pagesave për cdo vend pune;

Procesin e vlerësimit të performancës së punonjësve;

Saktësimin e nivelit të pagesës sipas gradave të punonjësve të MNZSh;

Përditësimin e plotësimin e dokumentacionit në dosjet personale të punonjësve;

Vlerësimin e nevojave për trajnim të punonjësve;

Miratimin e rregullave dhe ndjekjen e tyre për procedurën e palnifikimit dhe zbatimit të lejeve vjetore;

Përcaktimin e riskut për sektorin e IT;

Hartimin e politikave për sigurinë e informacionit dhe planet për sigurinë e sistemeve të IT në mbrojtjen e të dhënave;

Ngritjen e rrjetit të të brendshëm të postës elektronike;

Hartimin e rregullave për shfrytëzimin e dokumentacionit të arkivës;

Identifikimin dhe vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë, miratimin e tij në këshillin bashkiak;

Hartimin dhe miratimin në këshillin bashkiak të strategjisë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;

Hartimin dhe miratimin në këshillin bashkiak të planit vendor për emergjencat civile;

Zbatimin e detyrimeve ligjore të bashkisë që lindin nga neni 30 I ligjit 45, dt.18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”.

Në përfundim të auditimit për verifikimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve, nga 18 rekomandime gjithësej rezultuan të zbatuara 11 prej tyre dhe në proces zbatimi 7 rekomandime.

Drejtorinë e financës në drejtim të shlyerjes së detyrimeve financiare të prapambetura, për të cilën janë kryer angazhime auditimi edhe në 3 vitet e mëparshme, ka pasur përmirësime të dukshme.

Detyrimet e mbetura në fund të vitit 2020 për shumën **53.3 milion lek**, në fund të 9 muorit 2021 kapin vlerën **9.9 milion lek**. Vlerësohet nga auditimi një ulje e ndjeshme.

Në përfundim të angazhimit kanë rezultuar mangësi në:

Përcaktimin e risqeve kryesore në fushën e detyrimeve financiare të prapambetura, mbi bazën e të cilave të hartohet dhe plani veprimit për minimizimin e tyre;

Përditësimin e rregullores së funksionimit të drejtorisë në lidhje me detyrat e përgjegjësitë e cdo punonjësi për detyrimet financiare të prapambetura;

Garantimin nga nëpunësi zbatues i planifikimit të saktë të shpenzimeve dhe rishpërndarjes së fondeve;

Zgjidhjen e shlyerjes së dy detyrimeve për vendime gjyqësore me vlerën 444.098 lek të trashëguara nga viti 2000;

Përfshirjen në kontabilitet dhe pasqyrimin në bilanc të të gjitha detyrimeve kreditore;

Mbajtjen e kartelave financiare për cdo kreditor;

Respektimin e afateve kohore në shlyerjen e detyrimeve;

Zbatimin e penaliteteve në rastet e shkeljeve të afateve të parashikuara në kontratë;

**Raporti vjetor për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimet e vitit 2021 nga Drejtoria e
Auditimit Brendshëm - Bashkia Korçë**

Planifikimi buxhetor të sigurojë financim të mjaftueshëm në vitin ushtrimor përpara fillimit të procedurave të prokurimit;

Minimizimin e krijimit të detyrimeve dhe parandalimin e tyre në të ardhmen duke respektuar udhëzimet përkatëse për këtë fushë;

Shpërndarjen e barabartë të afatit kohor të realizimit të procedurave të prokurimit dhe të përmbushjes së kontratës;

Në përfundim të auditimit për verifikimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve, nga 11 rekomandime gjithësej rezultuan të zbatuara 8 prej tyre dhe në proces zbatimi 3 rekomandime.

Sektorin e Integritit European, strukturë brënda bashkisë, krijuar në vitin 2019, ka detyra për implementimin e projekteve me fondet e BE-së. Në vitin 2021 është kryer angazhimi i auditimit për projektin LOCAL CLUSTERS & SOCIAL ENTERPRISES INCUBATORS IN THE FIELDS OF CULTURE/TOURISM & FOLK TRADITION, quajtur shkurt INCLUST, me donator European Union. Në implementimin e këtij projekti kanë rezultuar mangësi në:

Respektimin e afatit 6 mujor të raportimit të ecurisë së projektit, për të përfituar sa më shpejt fondet;

Respektimin e afatit 60 ditor të likuidimit të detyrimeve për faturat e mallrave e shërbimeve;

Bërjen hyrje në magazinë të produkteve menjëherë me ardhjen e faturës;

Kontabilizimin dhe rregjistrimin në rregjistrin e aktiveve të produkteve të përfituara nga projekti;

Identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që rrezikojnë realizimin e projekteve me fondet e BE.

Plotësimin e vendeve vakante në sektorin e Integritit European.

Hartimin e rregullores së brendshme për sektorin e Integritit European.

Në përfundim të auditimit për verifikimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve, nga 7 rekomandime gjithësej rezultuan të zbatuara 5 prej tyre dhe në proces zbatimi 2 rekomandime.

Athinulla TREBICKA

Drejtuese e Njesisë

Korçë; 07 prill 2022

**Raporti vjetor për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimet e vitit 2021 nga Drejtoria e
Auditimit Brendshëm - Bashkia Korçë**

**M I R A T O H E T
SOTIRAQ FILO**

KRYETAR I BASHKISE